



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 222

Tiranë – E enjte, 27 nëntor 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 60/2025, datë 6.11.2025	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 7, datë 1.10.2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, ‘Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit’”, të ndryshuar..... 27867
Dekret i Presidentit nr. 396, datë 25.11.2025	Për shpallje ligji..... 27867
Ligj nr. 61/2025, datë 6.11.2025	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 1.10.2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014, ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’”, të ndryshuar..... 27867
Dekret i Presidentit nr. 397, datë 25.11.2025	Për shpallje ligji..... 27867
Ligj nr. 62/2025, datë 6.11.2025	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 1.10.2025, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, ‘Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme’”, të ndryshuar..... 27868
Dekret i Presidentit nr. 398, datë 25.11.2025	Për shpallje ligji..... 27868
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 688, datë 26.11.2025	Për lirim dhe emërim në detyrë..... 27868
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 689, datë 26.11.2025	Për lirim dhe emërim në detyrë..... 27868
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 690, datë 26.11.2025	Për lirim dhe emërim në detyrë..... 27869

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 691, datë 26.11.2025	Për lirim dhe emërim në detyrë.....	27869
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 26.11.2025	Për lirim dhe emërim në detyrë.....	27869
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 693, datë 26.11.2025	Për lirim nga detyra.....	27869
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 694, datë 26.11.2025	Për emërim në detyrë.....	27870
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 26.11.2025	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1178, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.....	27870
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 697, datë 26.11.2025	Për një shtesë në vendimin nr. 711, datë 20.11.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për marrëdhëniet e avokaturës së shtetit dhe personave juridikë, në kuadër të ofrimit të asistencës juridike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale’”	27872
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 711, datë 26.11.2025	Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit 2025.....	27872
Urdhër i Ministrisë së Financave nr. 147, datë 26.11.2025	Për delegimin e kompetencave.....	27874
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 1195, datë 10.11.2025	Për delegim kompetence.....	27875
Urdhër i i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 1196, datë 10.11.2025	Për delegim kompetence.....	27876

**LIGJ**
Nr. 60/2025

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT,
NR. 7, DATË 1.10.2025, “PËR DISA
NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN
NR. 8402, DATË 10.9.1998,
‘PËR KONTROLLIN DHE
DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË
NDËRTIMIT’”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 7, datë 1.10.2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

Miratur në datën 6.11.2025.

**Shpallur me dekretin nr. 396, datë 25.11.2025,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

DEKRET
Nr. 396, datë 25.11.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 60/2025, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 7, datë 1.10.2025, ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, ‘Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit’, të ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 61/2025

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 8,
DATË 1.10.2025, “PËR DISA NDRYSHIME
DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 107/2014,
‘PËR PLANIFIKIMIN DHE
ZHVILLIMIN E TERRITORIT’”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 1.10.2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014, ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’, të ndryshuar.

Miratur në datën 6.11.2025.

**Shpallur me dekretin nr. 397, datë 25.11.2025,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

DEKRET
Nr. 397, datë 25.11.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 61/2025, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 1.10.2025, ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014, ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’, të ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**LIGJ**
Nr. 62/2025

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 9, DATË
1.10.2025, “PËR DISA SHTESA DHE
NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9780,
DATË 16.7.2007, ‘PËR INSPEKTIMIN
DHE MBROJTJEN E TERRITORIT NGA
NDËRTIMET E KUNDËRLIGJSHME”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 1.10.2025, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, ‘Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar.

Miratuar në datën 6.11.2025.

**Shpallur me dekretin nr. 398, datë 25.11.2025,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

DEKRET
Nr. 398, datë 25.11.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 62/2025, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 1.10.2025, ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, ‘Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme’, të ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 688, datë 26.11.2025

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Blerta Rama, zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, lirohet nga kjo detyrë dhe emërohet zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 689, datë 26.11.2025

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Olta Manjani, zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, lirohet nga kjo detyrë dhe emërohet zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 690, datë 26.11.2025****PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Enkelejd Musabelliu, zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, lirohet nga kjo detyrë dhe emërohet zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 691, datë 26.11.2025****PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Denada Seferi, zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lirohet nga kjo detyrë dhe emërohet zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 692, datë 26.11.2025****PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Ina Majko, zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lirohet nga kjo detyrë dhe emërohet zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 693, datë 26.11.2025****PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Entela Ramosaçaj, zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 694, datë 26.11.2025****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Oltjon Muzaka emërohet zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 696, datë 26.11.2025**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 1178, DATË 24.12.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E DOKUMENTACIONIT
DHE RREGULLAVE TË HOLLËSISHME
TË EVIDENTIMIT TË NDËRTIMEVE
PA LEJE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, pika 6, dhe 69, pika 9, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1178, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në kreun III bëhen këto ndryshime:

a) Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Në zbatim të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Agjencia Shtetërore e Kadastrës trajton kryesisht ndërtimet pa leje të evidentuara nga vetë institucioni, gjatë proceseve të regjistrimit fillestar, të përmirësimit të

zonës kadastrale, ose të evidentimit në terren të ndërtimeve pa leje. Në momentin e evidentimit në terren, subjekti plotëson formularin e deklarimit të të dhënave të ndërtimit pa leje, të vënë në dispozicion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës gjatë procesit të evidentimit. Formulari i deklarimit të të dhënave të ndërtimit pa leje është sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

b) Pika 13 ndryshohet si më poshtë vijon:

“13. Drejtoria vendore e ASHK-së kryen këto veprime:

a) Për ndërtimet pa leje, për të cilat evidenton përfshirjen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, sipas neneve 17, pika 1, dhe 69, pika 9, të këtij ligji, njofton zyrtarisht subjektin për përfshirjen në fushën e zbatimit të ligjit dhe i përcjell faturën për arkëtim për shlyerjen e tarifës së shërbimit në vlerën 3 000 (tre mijë) lekë. Subjekti duhet të shlyejë pagesën brenda afatit 30-ditor (tridhjetëditor) nga momenti i marrjes dijeni.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës vijon me procedurat administrative për shqyrtimin e dokumentacionit dhe të përmbushjes së kriterëve ligjore të legalizimit të parashikuara në vendimin nr. 1040, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit për ndërtimet pa leje”, të ndryshuar.

b) Për ndërtimet pa leje, për të cilat evidenton mospërfshirjen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, sipas neneve 17, pika 1, dhe 69, pika 9, të këtij ligji, del me akt administrativ “Urdhër për evidentimin e mospërfshirjes”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga momenti i evidentimit në terren, dhe njofton subjektin për mospërfshirjen në fushën e zbatimit të ligjit.”.

2. Aneksi 2, “Kërkesë për legalizim të ndërtimit pa leje”, zëvendësohet me aneksin 2, “Formular i deklarimit të të dhënave të ndërtimit pa leje”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

II. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FORMULAR I DEKLARIMIT TË DHËNAVE
TË NDËRTIMIT PA LEJE

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: _____ E-mail: _____ Web: _____ Shënim: Lutemi plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë:	KAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN Drejtoria Vendore e ASHK _____ Nr. _____ Prot, datë ____ / ____ / ____
--	--

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN/ËT

1. Emër, Atësi Mbiemër: _____
 Nr. identifikimi (ID): _____, Nr. cel: _____, Adresa: _____
 2... _____

ose

Përfaqësuesi i autorizuar me prokurën nr. _____, datë _____:
 1. Emër, Atësi, Mbiemër: _____
 Nr. identifikimi (ID): _____, Nr. cel: _____,
 Adresa: _____

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

Në mbështetje të nenit 17, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e dokumentacionit dhe rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje", kërkoj përfshirjen në fushën e legalizimit të ndërtimit pa leje të llojit:

☒ Objekt, ☐ Shtesë, ☐ Objekt me shkelje të lejes së ndërtimit me adresë: _____
Rruga, Njësia e vetqeverisjes vendore

Deklaroj se ndërtimi është ngritur në ritin _____

SEKSIONI C: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR

Kërkesa shoqërohet (opsionale) nga:
 Dokumentacioni i pronësisë mbi truallin: _____
 Dokumentacion shoqërues: _____
 Kopje të dokumentit të identifikimit _____

Deklaruesi

 (Emër Atësi Mbiemër)

Për Drejtorinë Vendore të ASHK-së

 (Emër Mbiemër-Firmë)

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe jam i vetdijshëm se në të kundërt do të nënshtrohem përgjegjësisë penale sipas ligjit.

ASHK i bashkëlidh kërkesës, certifikatën e gjendjes familjare të momentit të aplikimit, të kërkuarit.

**VENDIM****Nr. 697, datë 26.11.2025****PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 711, DATË 20.11.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR MARRËDHËNIET E AVOKATURËS SË SHTETIT DHE PERSONAVE JURIDIKË, NË KUADËR TË OFRIMIT TË ASISTENCËS JURIDIKE, ROLIN E AVOKATËVE TË SHTETIT NË GJYKIM, SI DHE NORMAT E POSAÇME PROCEDURALE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 7, e 12, pikat 2 e 6, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin, që i bashkëlidhet vendimit nr. 711, datë 20.11.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit dhe personave juridikë, në kuadër të ofrimit të asistencës juridike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale”, pas nenit 5 shtohet neni 5/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 5/1**Regjistri i çështjeve gjyqësore**

1. Pranë Avokaturës së Shtetit krijohet “Regjistri i çështjeve gjyqësore” për çështjet, në të cilat personat juridikë ose Republika e Shqipërisë është palë.

2. Çdo person juridik, të cilit i ofrohet shërbimi i përfaqësimit nga Avokatura e Shtetit, nëpërmjet personit të kontaktit të caktuar sipas nenit 5, të kësaj rregulloreje, duhet t’i ofrojë asaj informacion për të gjitha çështjet gjyqësore, ku është palë, gjykatën kompetente, shkallën dhe fazën e gjykimit të secilës çështje, datën dhe orën e zhvillimit të seancës së radhës, personin përgjegjës të caktuar nga personi juridik për të ndjekur çështjen, si dhe çdo informacion tjetër që gjykohet i nevojshëm nga Avokatura e Shtetit dhe që ka lidhje me çështjen.

3. Avokatura e Shtetit regjistron e përditëson informacionin e parashikuar në pikën 2, të këtij neni, dhe informacionin për çështjet, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, në regjistrin e çështjeve gjyqësore.

4. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit përcakton formatin e regjistrit të çështjeve gjyqësore, mënyrën e mbajtjes e të përditësimit të të dhënave të këtij regjistri, si dhe të dhënat që mund të bëhen publike.

5. Në çdo rast, kur përfaqësuesi i autorizuar i personit juridik nuk merr pjesë në proceset gjyqësore, ku ky i fundit është palë, Avokatura e Shtetit njofton:

- a) titullarin e institucionit shtetëror;
- b) titullarin e entit publik;
- c) administratorin e shoqërisë.”.

II. Personat juridikë dërgojnë pranë Avokaturës së Shtetit informacionin e parashikuar në nenin 5/1 të rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit dhe personave juridikë, në kuadër të ofrimit të asistencës juridike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale”, bashkëlidhur vendimit nr. 711, datë 20.11.2024, të Këshillit të Ministrave, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Avokatura e Shtetit krijon regjistrin e çështjeve gjyqësore brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

III. Ngarkohen Avokatura e Shtetit dhe personat juridikë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****VENDIM****Nr. 711, datë 26.11.2025****PËR SHPËRBLIMIN E PENSIONISTËVE PËR FESTAT E FUNDVITIT 2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Shpërblimin, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, të personave, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat që përfitojnë pension pleqërie deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

b) Personat që përfitojnë pension invaliditeti, pension familjar dhe pension social, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

c) Personat që nuk përfitojnë pension, por janë përfutues vetëm të trajtimit financiar, si fëmijë në përkujdesje të Republikës, sipas ligjit nr. 129/2021, “Për statusin fëmijë në përkujdesje të Republikës”;

ç) Personat që nuk përfitojnë pension, por janë përfutues vetëm të trajtimit të veçantë financiar, sipas neneve 5/1/“a” ose 5/1/“b”, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

d) Personat që nuk përfitojnë pension, por janë përfutues vetëm sipas ligjit nr. 8455 datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve që humbasin jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit”;

dh) Personat që nuk përfitojnë pension, por që trajtohen vetëm me shpërblimin financiar si veteranë të LANÇ-it, sipas vendimit nr. 190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, ‘Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar’”, si dhe personat, të cilët marrin vetëm pension të posaçëm për merita të veçanta, sipas dispozitave të ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

e) Personat që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të

Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nuk janë të punësuar në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

ë) Personat që përfitojnë pension deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”;

f) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar;

g) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar;

gj) Personat që përfitojnë pension për shkak të profesionit të vështirë, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas nenit 5, të ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.

2. Shpërblimin, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, të personave, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat që përfitojnë pension pleqërie me masë pensioni mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

b) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, mbi masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar;



c) Personat që përfitojnë pension me masë pensioni mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”;

ç) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, me masë përfitimi mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë;

d) Personat që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, me masë përfitimi mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

dh) Personat që nuk përfitojnë pension, por që përfitojnë vetëm pension shtetëror të posaçëm të caktuar, në përputhje me nenin 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

e) Personat që nuk përfitojnë pension nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, por përfitojnë pension suplementar të caktuar, sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar;

ë) Personat që përfitojnë pension për shkak të profesionit të vështirë, sipas nenit 5, të ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, me masë përfitimi mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë.

3. Të drejtën për të përfitur shpërblimin, në masën e përcaktuar sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, e kanë edhe ata persona që kanë datë të fillimit të përfitimit, deri në datën 31.12.2025, duke përfshirë edhe këtë datë, dhe kanë të drejtë të marrin vetëm një herë këtë shpërblim, pavarësisht se mund të përfitojnë më shumë se një përfitim.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 10 404 515 000 (dhjetë miliardë e katërqind e katër milionë e

pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë, e ndarë në 10 332 190 000 (dhjetë miliardë e treqind e tridhjetë e dy milionë e njëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë për shpërblimin dhe në 72 325 000 (shtatëdhjetë e dy milionë e treqind e njëzet e pesë mijë) lekë shpenzime administrative për dhënien e shpërblimit.

5. Shpërblimet kalohen në llogaritë e pensionistëve në muajin dhjetor 2025 dhe paguhen gjatë këtij muaji. Në rastet kur pagesat efektive nuk kryhen brenda muajit dhjetor 2025, ato të paguhen deri më datë 30.6.2026. Shpërblimet e patërhequra parashkruhen pas datës 30.6.2026.

6. Administrimi i fondeve buxhetore të shpërblimit të pensionistëve, caktimi i shpërblimit për çdo përfitues dhe pagesa realizohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Posta Shqiptare sh.a., dhe bankat e nivelit të dytë, sipas të njëjtave procedura, që zbatohen për administrimin e fondit të sigurimeve shoqërore.

7. Efektet financiare prej 10 404 515 000 (dhjetë miliardë e katërqind e katër milionë e pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekësh përballohen, si më poshtë vijon:

a) Në masën 9 700 000 000 (nëntë miliardë e shtatëqind milionë) lekë, nga fondi “Për bonusin e pensionistëve”, miratuar në buxhetin e vitit 2025;

b) Në masën 704 515 000 (shtatëqind e katër milionë e pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë, nga buxheti i planifikuar për sigurimet shoqërore, për vitin 2025.

8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Financave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 147, datë 26.11.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të



Ministrave”; dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, përfshirë kompetencat për miratimin dhe ekzekutimin e veprimeve financiare, znj. Mimoza Dhëmbi, drejtor i përgjithshëm i Buxhetit.

2. Kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri, të ushtrohen nga data 2.12.2025 deri në datën 5.12.2025.

3. Ngarkohet znj. Mimoza Dhëmbi për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Besmir Beja

URDHËR
Nr. 1195, datë 10.11.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të germës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të germës “c”, të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave znj. Nertila Mihali, drejtor i Drejtorisë së Investimeve dhe Shërbimeve, për sa vijon:

- Për të trajtuar dhe nënshkruar aktet dalëse, lidhur me korrespondencën me institucionet e varësisë dhe dhënien e orientimeve për problematika të ndryshme që lidhen me specifikat e sektorit (mirëmbajtjen e ambienteve edhe mirëadministrimin e aseteve të paluajtshme të institucionit, sigurinë e ambienteve në bashkëpunim

me strukturat e tjera, plotësimin e nevojave të institucioneve me mjete pune, pajisje, kancelari, etj.);

- Për të trajtuar dhe nënshkruar aktet për shpërndarjen e pajisjeve kompjuterike, orendi e pajisje të tjera, kancelari, materiale pastrimi, tonera, etj., për drejtoritë/zyrat vendore të ASHK-së dhe Drejtorinë e Përgjithshme, bazuar në kërkesat e tyre dhe gjendjen e magazinës së Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së;

- Për të nënshkruar autorizimet për lëvizjen e automjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme, si dhe aktet për shpërndarje karburanti në bazë të normativës së konsumit për çdo automjet për nevoja të lëvizjes së strukturave të institucionit për nevoja pune ose në mbështetje të urdhrave të punës/shërbimit të miratuar nga drejtori i përgjithshëm;

- Për të trajtuar kërkesat dhe nënshkruar aktet dalëse për shpërndarjen e karburantit për furnizimin me karburant të gjeneratorëve, në mbështetje të normativës së konsumit;

- Për të trajtuar kërkesat për kopje dokumentacioni të dosjeve personale të punonjësve të ASHK-së dhe nënshkrimin e kthimpërgjigjeve të këtyre kërkesave;

- Për të trajtuar dhe nënshkruar vërtetimet e punës për punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së;

- Për të nënshkruar shkresat dalëse përcjellë Departamentit të Administratës Publike për formularët e dekriminalizimit të punonjësve.

2. Pavarësisht delegimit të kompetencave sipas këtij urdhri, drejtori i Drejtorisë së Investimeve dhe Shërbimeve, nëse e gjykon të nevojshme, mund t'i përcjellë për nënshkrim drejtorit të përgjithshëm shkresat që i vlerëson të një rëndësie të veçantë.

3. Delegimi i kompetencës sipas këtij urdhri nuk përfshin aktet administrative dhe detyrat të cilat duhet të miratohen dhe të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

4. Në rast mungese në detyrë të drejtorit të Drejtorisë së Investimeve dhe Shërbimeve, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës, në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “c”, e Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë mungesës kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.



5. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri të ushtrohet duke filluar nga data e miratimit të këtij urdhri deri në shfuqizimin e tij.

6. Ngarkohet Drejtoria e Investimeve dhe Shërbimeve dhe znj. Nertila Mihali, dhe Sektori i Arkiv Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli

URDHËR
Nr. 1196, datë 10.11.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të gurmës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të gurmës “c”, të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave z. Parid Sinella, përgjegjës i Sektorit të Apelimit, për sa vijon:

- Për të trajtuar dhe nënshkruar aktet dalëse kërkesë për informacion dhe dokumentacion, lidhur me korrespondencën zyrtare me institucionet e varësisë të ASHK-së, në kuadër të trajtimit të kërkesë/ankesave pjesë e fushës së përgjegjësisë të Sektorit të Apelimit.

2. Pavarësisht delegimit të kompetencave sipas këtij urdhri, përgjegjësi i Sektorit të Apelimit, nëse e gjykon të nevojshme, mund t’i përcjellë për nënshkrim drejtorit të përgjithshëm shkresat që i vlerëson të një rëndësie të veçantë.

3. Delegimi i kompetencës sipas këtij urdhri nuk përfshin aktet administrative dhe detyrat të cilat duhet të miratohen dhe të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

4. Në rast mungese në detyrë të përgjegjësit të Sektorit të Apelimit, delegimi i kompetencës

konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “c”, e Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë mungesës kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.

5. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri, të ushtrohet duke filluar nga data e miratimit të këtij urdhri deri në shfuqizimin e tij.

6. Ngarkohet Sektori i Apelimit dhe z. Parid Sinella, dhe Sektori i Arkiv Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 64 lekë